



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kuvendi,

Duke respektuar Rezolutën për Kosovën të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, të datës 09 shtator 2010, në bazë të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 6.1 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhje plenare të mbajtur më 10 mars 2011, në propozim të Grupit Parlamentar të PDK-së, me përkrahje të GP KKR-së, të GP SLS-së dhe GP 6+, miraton këtë

REZOLUTË

Për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet dialogun midis dy shteteve të pavarura dhe sovrane, Kosovës dhe Serbisë, për çështje praktike, në interes të përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe të avancimit të agjendës evropiane për të dy shtetet dhe për rajonin.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës rikonfirmon parimin që dialogu midis dy palëve të lehtësohet nga BE dhe SHBA-të.
3. Dialogu i Kosovës dhe Serbisë do të jetë i përgatitur mirë, me agjendë të qartë dhe të përcaktuar paraprakisht, në marrëveshje ndërmjet palëve dialoguese, duke përfshirë edhe lehtësuesit e dialogut.
4. Agjenda e dialogut do të përfshij vetëm çështjet teknike të interesit të përbashkët, pa prekur në asnjë rast sovranitetin e Kosovës, subjektivitetin, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm kushtetues të Kosovës.
5. Obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës që t'ia paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës dokumentin themelor të dialogut brenda afatit ligjor.

6. I/e emëruari nga Kryeministri udhëheqës i delegacionit të Republikës së Kosovës për dialogun me Republikën e Serbisë do të informojë në baza të rregullta Komisionin për Politikë të Jashtme dhe komisionet tjera përkatëse të Kuvendit të Kosovës dhe do të raportoj, edhe në seancë plenare të Kuvendit të Kosovës.
7. Kuvendi i Republikës së Kosovës shpreh vullnetin e qytetarëve të Kosovës për të vendosur marrëdhënie të mira fqinjësore me Republikën e Serbisë, në të mirë të dy vendeve tona, popujve tanë, të integriteteve evropiane dhe të stabilitetit e prosperitetit të përgjithshëm të rajonit.
8. Kuvendi i Republikës së Kosovës riafirmon qëndrimin se bashkëpunimi rajonal, marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe dialogu janë kontribut për paqen e stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik të vendeve tona dhe të rajonit në përgjithësi si dhe për përshpejtimin e integriteteve evropiane dhe euro-atlantike.
9. Kuvendi i Republikës së Kosovës e rikonfirmon të drejtën kushtetuese për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që i nënshkruan Qeveria e Republikës së Kosovës

Nr. 04-R-001

Prishtinë, më 10 mars 2011

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Kuvendi-Skupština-Assembly

REZOLUTË PËR VERIUN E KOSOVËS

Duke u nisur nga neni 2.2 dhe nga neni 65.1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nga neni 6.1 i Rregullores së Kuvendit:

Duke u nisur nga e drejta e institucioneve për ushtrimin e kontrollit efektiv në tërë territorin e Kosovës;

Duke u nisur nga parimet bazë të dokumenteve ndërkombëtare për Kosovën;

Duke u nisur nga e drejta e shteteve sovrane për kontroll të kufijve të vet,

Kuvendi i Republikës së Kosovës , në seancën e datës 28 korrik 2011 nxori këtë:

Rezolutë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet të drejtën kushtetuese të institucioneve për ushtrimin e kontrollit të plotë në tërë territorin e Republikës së Kosovës
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon që të respektohen masat e reciprocitetit me Serbinë në të gjitha pikat doganore

3. Kuvendi i Republikës së Kosovës fton Bashkësinë Ndërkombëtare për të përkrahur institucionet e vendit në vendosjen e rendit dhe ligjit në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës u bën thirrje të gjithë qytetarëve, pa asnjë dallim, që të ruajnë qetësinë, rendin kushtetues dhe sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës
5. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria të vazhdojë në angazhimin e saj për vendosjen e autoritetit kushtetues në pikat kufitare 1 dhe 31 dhe në ndërmarrjen e veprimeve tjera për shtrirjen dhe ushtrimin e sovranitetit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës
Dr. Jakup Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Kuvendi

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6.1 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 6 shtator 2012, miratoi këtë:

R E Z O L U T Ë

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të marrë vendim për zëvendësimin e kodeve telefonike aktuale që Kosova i shfrytëzon (+381, +386 dhe +377), me kodin telefonik të Republikës së Shqipërisë (+355).
2. Në funksion të realizimit të këtij qëllimi, brenda një kohe shumë të shkurtër, t'i iniciojë negociatat me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë.
3. Në qoftë se kostoja e shkëputjes së kontratave aktuale valide me ofruesit e kodeve telefonike është më e lartë për vendin se sa respektimi i tyre deri në fund, këto kontrata të zbatohen deri në afatin e paraparë për përfundimin e tyre, por ato të mos vazhdojnë më tutje.

Nr. 04-R-07
Prishtinë, 6 shtator 2012

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Rezoluta i dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Parashtruesit të mocionit dhe
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të neneve 6. 1 dhe 52.2 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës,

Duke e respektuar dhe kujtuar gjithmonë të kaluarën e hidhur dhe luftën e përgjakshme të popullit tonë për liri e pavarësi,

Të përkushtuar për të ndërtuar një të ardhme në paqe dhe harmoni me fqinjët tanë,

Të vendosur për të punuar bashkërisht në integrimin e shpejtë të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në NATO,

Duke insistuar në implementimin e marrëveshjeve të arritura,

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 18 tetor 2012, me propozimin e Grupeve Parlamentare: PDK, AAK, KKR, SLS dhe Grupi 6+ , miraton këtë:

R E Z O L U T Ë

Për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet procesin e zgjidhjes së problemeve midis dy shteteve të pavarura dhe sovranë, Kosovës dhe Serbisë, në interes të normalizimit të marrëdhënieve në mes tyre, përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe avancimit të agjendës evropiane për të dy shtetet dhe për rajonin.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës rikonfirmon parimin që ky proces midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë të lehtësohet nga BE dhe të mbështetet fuqishëm nga SHBA-të.

3. Dialogu dhe rezultatet e tij duhet të jenë në pajtim me sovranitetin e Kosovës, subjektivitetin ndërkombëtar, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm-
rendin unik kushtetues të Kosovës.
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës e autorizon Qeverinë e Republikës së Kosovës
që të udhëheqë këtë proces, me pjesëmarrje të Komisioneve të nevojshme të
Kuvendit të Kosovës.
5. Qeveria e Republikës së Kosovës është e obliguar që të raportojë rregullisht për
procesin e normalizimit të relacioneve në mes të Republikës së Kosovës dhe
Republikës së Serbisë në Kuvendin e Kosovës.
6. Marrëveshjet e procesit të normalizimit të marrëdhënieve midis dy shteteve do të
ratifikohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Nr. 04-R-08

Prishtinë, më 18 tetor 2012

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65(1), (9), (14) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të neneve 6.1, 40 dhe 52(2) të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, dhe të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04-R-08 miratuar më 18 tetor, 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën e jashtëzakonshme plenare të mbajtur më 21 dhe 22 prill 2013, pas raportit dhënë nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për Marrëveshjen e Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, e cila është parafuar me 19 prill 2013 nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri i Republikës së Serbisë, miratoi këtë:

REZOLUTË

Për dhënien e pëlqimit për nënshkrim të Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë


1. Kuvendi i Republikës së Kosovës shpreh përkrahje dhe jep pëlqimin për nënshkrimin e Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve, mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, e cila është parafuar me 19 prill 2013 nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri i Republikës së Serbisë,

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështetë zotimet e përmbajtura në këtë Marrëveshje.
3. Kjo Rezolutë hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Nr. 04-R-10
Prishtina, 22 Prill 2013

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI



Rezoluta i dërgohet:

- Presidentes së Republikës së Kosovës,
- Grupeve të Kuvëndit të Republikës së Kosovës,
- Qeverisë së Republikës së Kosovës
- Arkivit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Kuvendi

Në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6.1 të Rregullores së Kuvendit,

Duke marrë parasysh:

Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (1948);

Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj;

Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare si dhe Instrumentet tjera Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut;

Gjendjen jo të mire politike, ekonomike, diskriminimin, cenimin e të drejtave dhe lirisë së shprehjes, mohimin e kultivimit të identitetit, kulturës, gjuhës dhe promovimit të vlerave tjera kombëtare dhe historike të shqiptarëve në Luginën e Preshevës (Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë);

Duke përfshirë platformën politike për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë të vitit 2006, deklaratën e 12 janarit 2013 dhe dokumentin e masave urgjente të shkurtit 2013;

Duke kërkuar që Institucionet e Republikës së Kosovës duhet të kenë më shumë kujdes dhe interesim gjithëpërfshirës për përmirësimin e gjendjes së shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë;

Duke pasur parasysh mos zbatimin e Marrëveshjes së Konçulit e cila ndali luftën çlirimtare të UÇPMB-së dhe forcave ushtarake dhe policore të Serbisë;

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 31 maj dhe 6 qershor 2013, miratoi këtë

R E Z O L U T Ë

PËR TË DREJTAT E SHQIPTARËVE NË PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të kushtëzojë marrëdhëniet me Serbinë, me kujdesin dhe interesimin shtetëror për përmirësimin e gjendjes së shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë lidhur me të drejtat e tyre civile, politike dhe etnike;

2. Qeveria e Republikës së Kosovës të ketë më shumë përkujdesje dhe trajtim më të mirë për qytetarët shqiptarë të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, të cilët janë shpërngulur në Kosovë duke iu garantuar të drejta të plota dhe të barabarta;
3. Qeveria e Republikës së Kosovës të hapë një zyre në Prishtinë dhe në Gjilan për qytetarët e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes dhe atyre të cilët janë shpërngulur nga atje sipas normave ndërkombëtare;
4. Të krijohen lehtësi të qarkullimit, shkollimit, afirmimit kulturor, pajisjeve me dokumente përkatëse si dhe lehtësi tjera, duke përfshirë suspendimin e taksës diskriminuese;
5. Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkon nga institucionet ndërkombëtare dhe institucionet relevante që të liroj të burgosurit politikë duke përfshirë të ashtuquajturin grupin e Gjilanit që janë viktimat të një procesi të montuar politik;
6. Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkojë reciprocitet të plotë me të drejtat e serbëve pakicë në veri të Kosovës;
7. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet nismën e themelimit të një Universiteti Publik në gjuhën shqipe dhe fton përfaqësuesit politikë dhe institucionalë të marrin nismë ligjore;
8. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet themelimin e fondit zhvillimor për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë me iniciativën e Qeverisë së Kosovës dhe në koordinim me institucionet ndërkombëtare dhe evropiane;
9. Kuvendi i Republikës së Kosovës fton Këshillin e Evropës dhe organizatat tjera ndërkombëtare që të angazhohen për detyrimin e Republikës së Serbisë për të respektuar të gjitha të drejtat që dalin nga Konventat ndërkombëtare;
10. Qeveria e Republikës së Kosovës të themelon grupin ndërministror për implementim që përfshin edhe vizitën e mundshme të Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian dhe Ministrisë për Integritet Evropian.

Nr. 04-R-011

Prishtinë, më 6 qershor 2013

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Cc:

- Presidentes së Republikës së Kosovës,
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës,
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6.1 të Rregullores së Kuvendit, pas debatit të zhvilluar në seancë të jashtëzakonshme më 18 qershor 2015, lidhur me ndalimin e kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe të deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga autoritete sllovene, në Lubjanë, z. Ramush Haradinaj, me propozimin e Grupit Parlamentar të AAK-së, si dhe harmonizimin e tekstit të rezolutës edhe me grupet e tjera parlamentare, miratoi këtë:

R E Z O L U T Ë

1. Qeveria dhe Presidentja e Kosovës urgjentisht të kërkojnë nga autoritetet sllovene, që deputetit të Kuvendit të Kosovës, ish-kryeministrit të Qeverisë së Kosovës dhe Kryetarit të AAK-së, z. Ramush Haradinaj pa asnjë kusht dhe menjëherë t'i kthehet pasaporta diplomatike dhe t'i lejohet kthimi në Kosovë.
2. Qeveria e Kosovës të kërkojë urgjentisht nga Brukseli pastrimin e menjëhershëm të listave, respektivisht të fletarrestimeve të lëshuara nga Serbia për ish-ushtarët e UÇK-së;
3. Institucionet e Kosovës t'i drejtojnë notë proteste shtetit slloven.

Nr. 05-R-02
Prishtinë, më 18 qershor 2015

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

CC:

- Presidente së Republikës së Kosovës,
- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Grupeve parlamentare,
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neneve 6.1 e 40 të Rregullores së Kuvendit, në seancë të jashtëzakonshme, të mbajtur më 11 dhe 12 tetor 2016, pas debatit parlamentar lidhur me arrestimin e zotit Nehat Thaçi, njëherësh epror i Policisë së Republikës së Kosovës, nga autoritetet e Serbisë, nxori këtë:

R E Z O L U T Ë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon lirimin e menjëhershëm të zotit Nehat Thaçi, epror i Policisë së Republikës së Kosovës.
2. BE-ja, si ndërmjetësues dhe garantues i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nëpërmjet mekanizmave të saj detyruet të ndërhyjë te Qeveria e Serbisë që të lirohet eprori Nehat Thaçi.
3. Çdo komunikim i Qeverisë së Republikës së Kosovës për rastin e arrestimit të zotit Nehat Thaçi, deri në lirimin e tij, të bëhet vetëm nëpërmjet Zyrës së znj. Federica Mogherini, Përfaqësuese e Lartë e Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë dhe zv./presidente e Komisionit Evropian.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës t’ia bëjë me dije BE-së se veprimet e tilla të Serbisë në raport me institucionet dhe qytetarët e Kosovës po e rrezikojnë thellë përmirësimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi dhe dialogun ndërmjet dy vendeve, duke na detyruar në reciprocitet.
5. Misioni i EULEX-it të deklarohet për rastin e zotit Thaçi dhe njëherësh kërkojmë angazhim të drejtpërdrejtë si mision me kompetenca të veçanta.
6. Kërkojmë nga Interpoli që Policia e Kosovës të bëhet pjesë e kësaj organizate dhe njëherësh insistojmë që fletë-arrestet politike të shpallura nga Serbia të largohen nga sistemi i tyre ligjor.

Nr. 05-R-05
Prishtinë, më 12 tetor 2016

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

CC:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë,
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 52, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, pas debatit të zhvilluar në seancat plenare të mbajtura më 23 dhe 29 dhjetor 2016, lidhur me ndërtimin e murit në mënyrë ilegale në pjesën Veriore të Mitrovicës, me propozimin e Grupit Parlamentar të AAK-së, mbështetur edhe nga grupet parlamentare: GP i PDK-së, GP i LDK-së, GP i LVV dhe GP “Nisma”, miratoi këtë:

R E Z O L U T Ë

1. Të rrënohet muri ilegal në pjesën veriore të Mitrovicës, kjo të ndodhë brenda muajit janar të vitit 2017.
2. Qeveria e Kosovës të angazhohet që organet kompetente për trajtimin e ndërtimeve pa leje t'i ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore për murin që është në ndërtim e sipër në pjesën e urës së Ibrit, i njëjti të trajtohet si veprim politik dhe ndërtim pa leje.
3. Qeveria e Kosovës të marrë masat e nevojshme që të mos ndryshohet ura e Ibrit dhe e njëjta t'i përmbajë të gjitha elementet që i kishte para vitit 1999, e jo t'i shtohen elemente tjera ilegale, siç është muri dhe shkallët.
4. Të bëhet e mundur që sa më parë qytetarët të kthehen në pronat e tyre, në të dy pjesët e qytetit të Mitrovicës.

Nr. 05-R-007

Prishtinë, më 29 dhjetor 2016

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

CC:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, në seancat plenare të mbajtura më 10 janar dhe 10 mars 2017, pas debatit të zhvilluar në lidhje me ndalimin e kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, me propozim të GP të AAK-së dhe me harmonizim të grupeve parlamentare: PDK, LDK, LVV dhe Nisma, miraton këtë:

R E Z O L U T Ë

Lidhur me ndalimin e ish-kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në Francë

1. Lirimi pa kushte i ish-kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj, të ndodhë sa më shpejt dhe të konsiderohet detyrë primare shtetërore.
2. Të pezullohet procesi i dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë deri në lirin e ish-kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkojë nga BE-ja që ta detyrojë Serbinë për t'i anuluar të gjitha aktakuzat dhe fletarrestet e lëshuara nga Serbia nëpërmjet Interpolit për shtetasit e Republikës së Kosovës.
4. Qeveria dhe institucionet tjera të Republikës së Kosovës obligohen t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që t'i informojnë të gjitha instancat ndërkombëtare se "...e refuzojnë juridiksionin universal të Serbisë për krimet e pretenduara në tërë territorin e ish-Jugosllavisë", dhe konform kësaj të kërkojnë lirin e ish-kryeministrit të Kosovës dhe kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Ramush Haradinaj.

Nr. 05-R-011

Prishtinë, më 10 mars 2017

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI

Kopja e Rezolutës u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

VI Saziv

Prolećno zasedanje

Skupština Republike Kosova, na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosova i člana 52 stav 2 Poslovnika Skupštine, nakon održane debate na plenarnim sednicama od 27. aprila i 3. maja 2018. u vezi nestalih lica, usvaja sledeću:

REZOLUCIJU

1. Da se rasvetli sudbina nasilno nestalih lica, na osnovu međunarodnih prava, uključujući Ženevske konvencije od 1949 i dodatnog protokola br. 1, 1977.
2. Rasvetljavanje sudbine nasilno nestalih lica da se postavi kao preduslov u dijalogu Kosovo – Srbija i da postane deo državne platforme za dijalog. Ovlašćene institucije za dijalog, dužne su da izveštavaju Skupštini i nadležnim komisijama o svakom sastanku sa srpskom stranu po ovom pitanju.
3. Nadležni subjekti parlamentarne politike i spoljne politike Kosova, u agendama sastanaka sa predstavnicima OUN-a EU-a, uticajnih država na međunarodne odnose, da fokusiraju prioritarno rasvetljavanje sudbine nasilno nestalih lica i o primeni tačaka Rezolucije da informišu Skupštine Kosova.
4. Svi nosioci dužnosti, na osnovu tačaka ove Rezolucije, da na poseban način pristupe dijalogu Kosovo – Srbije za rasvetljavanje sudbine Ukshin Hoti, zbog okolnosti njegovog nestanka, planirane od strane komandovanih vojnih struktura države Srbije, uključujući direktora zatvora Dubrave, u Istogu i Ministarstvo pravde Srbije.
5. Vlada Republike Kosovo da okonča do početka meseca juna 2018. koncept – dokument o pitanju nestalih lica i da prosledi sa izmenom – dopunom Zakon o nestalim licima, odnosno pravne osnove i da se isti prosledi Skupštini.
6. Vlada da razmatra prioriteto punu funkcionalizaciju Glavnog registra za nestala lica, uključujući i elektronsku verziju, sa mogućnosti digitalizacije i omogućavanja pristupa za javnost, u cilju povećanja transparentnosti.

7. Vlada da se angažuje za sklapanje sporazuma o razumevanju između Kosova i Srbije za takozvanu „pravnu pomoć“, slično sporazuma koji je sklopila Srbija sa Bosnom i Hercegovinom i Hrvatskom.

8. Nadležne institucije Republike Kosova da se angažuju i tuže Srbiju, kao glavna odgovorna za nestala lica, uključujući članove porodice pojedinačno ili grupno, na međunarodnim instancama.

9. Vlada se obavezuje da realizuje projekat za objavljivanje podataka u vezi nestalih lica kod spomenika van objekta Skupštine i da se dovrši rad na Memorijalu u Meji, Đakovica do kraja 2018.godine.

10. Da se povećaju institucionalni kapaciteti zemlje, u cilju većeg angažovanja o pitanju nasilno nestalih lica.

11. Da se izradi i prosledi Nacrt zakona, koji omogućuje suđenje u odsustvu optuženih za razne zločine.

Br. 06-R-003

Priština, 3. maj 2018.

Predsednik Skupštine,

Kadri VESELI

Rezoluciju dostaviti:

- Vladi Republike Kosova,
- Parlamentarnim grupama, i
- Arhivi Skupštine.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI


Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 52, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, pas Interpelancës së zhvilluar me kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në lidhje me Vendimin e Qeverisë së Kosovës, nr. 02/34 të datës 05 mars 2018, në Seancën plenare të mbajtur më 31 maj, 1, 4 dhe 5 qershor 2018, me propozimin e GP të LDK-së dhe të harmonizuar edhe me grupet tjera parlamentare, miraton këtë:

R E Z O L U T Ë

1. Obligohet Qeveria e Kosovës që në afat prej tre muajsh të vijë me propozim për zgjidhjen e situatës së krijuar.
2. KOSTT dhe ZRRE të përpilojnë planin e kompensimit të humbjeve të KOSTT, të shkaktuara nga udhëzimi i ZRRE për furnizim të rrymës në komunat e veriut të Kosovës.
3. Qeveria e Kosovës nuk duhet të vazhdojë dialogun me Serbinë për çfarëdo çështje që ndërlidhet me energjinë, pa zbatimin e plotë të marrëveshjes ekzistuese.
4. Të krijohet një Grup Punues, i përberë nga Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës, KOSTT dhe ZRRE për të koordinuar veprimet për tejkalimin e situatës së krijuar.

Nr. 06-R- 008
Prishtinë, më 05.06.2018

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Rezoluta u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Grupeve parlamentare dhe
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 52, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, në seancën e jashtëzakonshme, të mbajtur më 15 dhjetor 2018, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, miratoi këtë:

REZOLUTË

Mbi procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë

I. Parimet e Marrëveshjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse

Procesi i Dialogut dhe i bisedimeve kuptohet si mënyrë efikase dhe e vetme për arritje të marrëveshjeve të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse, ndërkombëtarisht të pranueshme dhe ligjërish të obligueshme ndërmjet dy shteteve fqinje: Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe përfaqësuesit e tyre politikë, procesi i dialogut do të jetë i pranueshëm vetëm nëse përfundimi i tij do të rezultojë në:

- Njohje të ndërsjellë të shtetësisë nga palët e përfshira në proces;
- Anëtarësim të Republikës së Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB)
- Zotim të verifikueshëm për përshpejtimin e proceseve integruese të Republikës së Kosovës në Bashkim Evropian dhe në NATO.

II. Përkufizimi dhe korniza e dialogut

Kuvendi i Republikës së Kosovës konsideron se për qytetarët dhe përfaqësuesit politikë të Republikës së Kosovës janë tri çështje fundamentale që e formësojnë kornizën, përmbajtjen dhe karakterin e Procesit të Dialogut dhe të Marrëveshjes Gjithëpërfshirëse të dala nga ai:

- **Integriteti territorial dhe karakteri unitar i shtetit të Kosovës**
Kuvendi i Republikës së Kosovës rithekson se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, sovraniteti shtetëror, integriteti territorial dhe karakteri unitar shtetëror i Republikës së Kosovës janë të pacenueshme dhe të patjetërsueshme.
- **Interesi strategjik i shtetit të Kosovës**
Republika e Kosovës synon të zhvillojë dhe mirëmbajë fqinjësi të mirë, të anëtarësohet në Aleancën e NATO-s dhe në Bashkimin Evropian. Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk do të përkrahë një proces të bisedimeve, i cili do ta kontestojë apo relativizojë këtë interes strategjik të shtetit të Kosovës dhe të qytetarëve të saj.
- **Republika e Kosovës është rregullim shtetëror i demokracisë parlamentare dhe i shoqërisë sekulare brenda traditës multikulturore**
Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk do ta përkrahë një proces të bisedimeve i cili nuk i përfill dhe i konteston këto fundamente strukturore dhe identitare të shtetit të Kosovës.

III. Platforma dhe Ligji për Procesin e Dialogut

Kuvendi i Republikës së Kosovës do të angazhohet për arritjen e një konsensusi sa më të gjerë ndërmjet përfaqësuesve politikë, shoqërisë civile dhe qytetarëve të vendit për Procesin e Dialogut.

Procesi i arritjes së këtij konsensusi do të zhvillohet nëpërmjet hartimit të Platformës së Dialogut, dokument i cili do të përmbajë dhe interpretojë parimet themeltare dhe pozicionet shtetërore mbi të cilat do të zhvillohet dialogu Kosovë - Serbi.

Po ashtu, Kuvendi i Republikës së Kosovës do ta votojë Ligjin për Dialogun me të cilin do të sigurohet vlefshmëria juridike dhe sanksionimi ligjor i përmbajtjes së Platformës së Dialogut dhe të përgjegjësi të përfaqësuesve të Delegacionit Shtetëror.

- Në përpjekje për ta promovuar baraspeshën ndërpartiake me qëllim të arritjes së konsensusit sa më të gjerë politik, Platforma për Dialogun do të hartohet nga një grup i kryesuar nga një përfaqësues i opozitës parlamentare, pjesëmarrës në Procesin e Dialogut.
- Komisioni për Hartimin e Platformës së Dialogut do të formohet dhe përbëhet nga anëtarët e Delegacionit Shtetëror, duke përfshirë edhe përfaqësuesin e Shoqërisë Civile, të votuar paraprakisht me procedurë parlamentare për anëtar të Delegacionit.

1. Afatet për hartimin dhe funksionalizimin e Platformës dhe Ligjit për Dialogun

Delegacioni Shtetëror do të obligohet që brenda afatit 30 ditësh nga themelimi dhe funksionalizimi i tij t'ia paraqesë Kuvendit të Republikës së Kosovës projekt-dokumentet, si në vijim:

- Projekt-Platformën e Dialogut, ku do të saktësohen të gjitha parimet udhëheqëse mbi të cilat Delegacioni Shtetëror do ta përfaqësojë Republikën e Kosovës në procesin e Dialogut;
- Projekt-Ligjin mbi Dialogun, me të cilin do të definoohen dhe saktësohen kompetencat, përgjegjësitë dhe fusha e veprimit të Delegacionit Shtetëror dhe të përfaqësuesve të tij në Procesin e Dialogut.

IV. Delegacioni Shtetëror: struktura, mandati, funksionimi dhe mbikëqyrja

Kuvendi i Republikës së Kosovës do ta votojë dhe mandatojë një Delegacion Shtetëror, i cili do të jetë entiteti/organi i vetëm i autorizuar për t'u angazhuar në Procesin e Dialogut.

Delegacioni Shtetëror do ta mbajë të drejtën ekskluzive të komunikimit dhe të interpretimit publik të procedimeve, përmbajtjes dhe arritjeve në Procesin e Dialogut.

- Delegacioni Shtetëror i ka 12 (dymbëdhjetë) anëtarë, prej të cilëve 7 (shtatë) do të jenë nga partitë e koalicionit qeveritar, 4 (katër) nga partitë opozitare, dhe 1 (një) përfaqësues i Shoqërisë Civile. Delegacioni do të bashkëdrejtohet barabarësisht prej 2 (dy) përfaqësuesve, njëri nga radhët e opozitës parlamentare dhe tjetri nga koalicionit qeveritar. Të dy bashkëdrejtuesit do të votohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës, së bashku me Delegacionin Shtetëror.
- Po ashtu, duke synuar përfaqësimin sa më të gjerë dhe të barabartë të vullnetit të qytetarëve të Kosovës, një përfaqësues nga Shoqëria Civile do të jetë anëtar i rregullt i Delegacionit Shtetëror.

Delegacioni Shtetëror do të përbëhet nga këta përfaqësues politikë të votuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës:

- Shpend Ahmeti (PSD), Fatmir Limaj (Nisma), bashkëdrejtues
- Enver Hoxhaj (PDK), anëtar
- Avni Arifi (AAK), anëtar
- Behgjet Pacolli (AKR), anëtar
- Visar Ymeri (PSD/vend i rezervuar për opozitën), anëtar
- Dukagjin Gorani (PSD/ vend i rezervuar për opozitën), anëtar

- Mahir Yagcilar (Grupi 6+), anëtar
- Dardan Gashi (zv/km), anëtar
- Një anëtar nga Shoqëria Civile
- Një përfaqësues i komunitetit boshnjak
- Një përfaqësues nga opozita

1. Udhëheqja dhe mbikëqyrja proporcionale

Komisionet punuese përbëjnë bërthamën e Delegacionit Shtetëror. Pavarësisht numrit të tyre, udhëheqja profesionale dhe mbikëqyrja politike do të shpërndahet barabarësisht (50:50) ndërmjet përfaqësuesve të subjekteve pjesëmarrëse të pushtetit dhe opozitës.

2. Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrje të Dialogut

Delegacioni Shtetëror do të raportojë në mënyrë të rregullt rreth ecurisë së procesit të dialogut para Komisionit për Mbikëqyrjen e Dialogut.

- Komisioni për Mbikëqyrjen e Dialogut do të themelohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ai do të përbëhet nga përfaqësues të të gjitha subjekteve parlamentare dhe do të plotësohet me anëtarë të përzgjedhur nga Shoqëria Civile.
- Komisioni për Mbikëqyrjen e Dialogut do të udhëhiqet nga një përfaqësues i partive opozitare, pjesëmarrëse në Procesin e Dialogut.

3. Vendimmarrja në Delegacionin Shtetëror

Vendimet në Delegacionin Shtetëror do të jenë konsensuale. Me konsensus në këtë rast do të nënkuptohet procedura e arritjes së pajtimit të njëzëshëm/unanim të të gjithë përfaqësuesve të subjekteve pjesëmarrëse në Procesin e Dialogut.

V. Roli qendror i Kuvendit të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut

Kuvendi i Republikës së Kosovës mban rol qendror në Procesin e Dialogut.

Delegacioni shtetëror, i votuar dhe i mandatuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka të drejtë dhe mban përgjegjësi të negocimit dhe arritjes së marrëveshjes gjatë Procesit të Dialogut.

- Mandati i liderëve institucionalë të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut do të jetë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Çdo veprim i tyre përtej mandatit të saktësuar me Kushtetutë do të konsiderohet i pavlefshëm dhe do të përbëjë shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës.
- Mandati i përfaqësuesve të tjerë në Delegacionin Shtetëror do të jetë në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e mbarështuara në Platformën dhe Ligjin për Dialogun. Çdo veprim i tyre përtej këtyre kompetencave do të konsiderohet i pavlefshëm dhe do të përbëjë shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe të ligjeve të Republikës së Kosovës.
- Marrëveshja përfundimtare, e cila mund të arrihet në Procesin e Dialogut, do t'i nënshtrohet një referendumi konsultativ para se të votohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
- Çfarëdo veprimi i institucioneve të Republikës së Kosovës në raport me Republikën e Serbisë duhet të bashkërendohet dhe të miratohet dyanshëm ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Delegacionit Shtetëror.
- Marrëveshja përfundimtare, e cila mund të arrihet në Procesin e Dialogut, do të konsiderohet e vlefshme vetëm pas ratifikimit të saj në Kuvendin e Republikës së Kosovës sipas procedurës kushtetuese për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve.

Nr. 06-R- 015

Prishtinë, 15. 12. 2018

Kryetari i Kuvendit
Kadri VESELI

Rezoluta u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Grupeve parlamentare dhe
- Arkivit të Kuvendit.